

E nderuar Zonjë

E nderuar Zonjë

Ju ftojmë që të merrni pjesë në programin e parandalimit të kancerit të qafës së mitrës promovuar nga Regione Emilia Romagna që i drejtohet të gjitha grave nga mosha 25 deri në 64 vjeç.

Programi, për gratë me më shumë se 30 vjeç, bazohet në kryerjen e testit HPV për zbulimin e Human Papilloma Virus. Është e vërtetuar, nga studimet e fundit shkencore, se ky test është efikas në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës në këtë moshë

Ju ofrojmë një takim në

Konsultoren.....
rruga
në

Shihni letrën origjinale

Letra e ftesës dhe fletushka e bashkangjitur janë dërguar në Dosjen Shëndetsore Elektronike (nëse e keni aktivizuar), mjekut të familjes dhe me postë të zakonshme në vendbanimin tuaj.

Marrja e kampionit për testin HPV është i njëjtë me atë të Pap test, kryhet nga një mami dhe është i thjeshtë, i shpejtë dhe pa dhimbje. Analiza është falas, si dhe çdo kontroll tjetër i mëtejshëm, dhe nuk nevojitet receta e mjekut.

Nëse keni nevojë mund t'ju japim një certifikatë për të justifikuar mungesën nga puna.

Nëse nuk mund të kryeni testin në ditën e caktuar dhe dëshironi të spostoni takimin ose të merrni më shumë informacione, telefononi në numrin 800 300315, ose ju mund të dërgoni një email tek: scp@ausl.mo.it.

Ju kujtojmë:

- të kryeni testin kur të keni mbaruar menstruacione prej tre ditëve dhe mos të keni më humbje gjaku
- të mos kryeni marrëdhënie seksuale dy ditë para analizës
- të mos përdorni suposta, krem ose larje tw brendwshme në tre ditët përpara analizës
- mund ta bëni testin edhe nëse jeni shtatzanë

Do ju dërgojmë një letër në shtëpi me rezultatin e analizës dhe me udhëzimet për kontrollet e mëtejshme.

Nëse testi i HPV do të dali pozitiv, kampioni i mbledhur do të përdoret edhe për të kryer Pap test.

Nëse do të jenë të nevojshme kërkime më të detajuara do ju telefonojmë personalisht.

Nëse keni vështirësi të rënda lëvizshmërie na njoftoni disa ditë para takimit: në mënyrë që t'ju ofrojmë një kujdes më të mirë.

JU MIRËPRESIM !

Me rrespekt.